



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.44/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vodosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së pllakatës në shtyllat e ndriçimit publik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohen** si të bazuara ankesat e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 550.00 (pesqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 22.09.2017 dhe 23.09.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa: Anr.44/2017 nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Anr.51/2017 nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilat pretendohet se me datën 22.09.2017, në rrugën “Remzi Ademaj” që lidhet me rrugën “Adem Jashari” në Prizren, kanë hasur në pllakatë të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të vodosur në hapësira publike përkatësisht në shtyllat e ndriçimit publik. Me këtë rast parashtruesit e ankesës theksojn se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që është vodosur pllakata e kandidatit në hapësirë publike.

Parashtruesit e ankesës si dëshmi kanë bashkangjitur fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me Zl.Anr.44/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe të dy dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Në përgjigjen në ankesë të datës 23.09.2017, subjekti politik PDK ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se është bërë nga aktivistë të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, dhe se pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjetës në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur tri fotografi nga vendi ku janë larguar pllakatat. Ndërsa për pretendimin e dytë të subjektit politik LVV, në përgjigje subjekti politik PDK thekson se lidhur me shkeljen në fjalë është parashtuar një ankesë më herët nga KDI, ku subjekti politik ka ndërmarr masat për të përmirësuar shkeljen.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se pllakata të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunalë nga radhët e subjektit politik PDK janë ngjitur në shtyllat e ndriçimit publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur nisi 33, pika b), të LZP-së, pasi që pllakata të kandidatit për këshilltar komunalë të subjektit politik PDK-së, janë vendosur në shtyllat e ndriçimit publik. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik PDK, në përgjigjen në ankesë të datës 23.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Partia Demokratike e Kosovës, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti pllakata të kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afsatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr pllakatat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 44/2017 më datën 25.09.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Gyltene Sylejmani



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.